

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve

SKELETKURRIKULI

Për Profilin Mësimor
GUIDË TURISTIKE

Niveli III i KSHK
(1 vjeçar)

(Në drejtimin mësimor Hoteleri - Turizëm)

Kodi: G4-III-22

Miratoi:

MINISTRI

Tiranë, 2022

Përmbajtja:

I. Qëllimet e arsimit profesional në profilin “Guidë turistike”, niveli III i KSHK, të drejtimit mësimor “Hoteleri-turizëm”.

II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në profilin “Guidë turistike”, niveli III i KSHK.

1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në profilin “Guidë turistike”, niveli III i KSHK
2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin “Guidë turistike”, niveli III i KSHK
3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin “Guidë turistike”, niveli III i KSHK
4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit në profilin “Guidë turistike”, niveli III i KSHK.

III. Plani mësimor për profilin “Guidë turistike”, niveli III i KSHK.

IV. Udhëzime për planin mësimor

V. Udhëzime për procesin mësimor.

VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.

VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit në profilin “Guidë turistike”, niveli III i KSHK.

VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.

IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar.

X. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar.

I. Qëllimet e arsimit profesional në profilin “Guidë turistike”, niveli III i KSHK, të drejtimit “Hoteleri-turizëm”.

Qëllimi kryesor i arsimit profesional në profilin “Guidë turistike”, niveli III i KSHK, të drejtimit “Hoteleri-Turizëm”, është *“zhvillimi i personalitetit të nxënësve për të jetuar në përshatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre për t’u punësuar dhe vetpunësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me shërbimet e organizuara nga operatorë turistike dhe agjenci turistike të udhëtimit, hotele, kompani etj., për drejtimin e grupeve turistike.* Për të realizuar këtë, shkolla profesionale u krijon nxënësve:

- mundësi të përshatshme për të nxënë, pavarësisht nga gjinia, raca, besimi dhe aftësitë;
- mundësi për të gjithë, për të zhvilluar kompetencat profesionale, të bazuara në njohuritë, shprehitë, qëndrimet dhe vlerat, të mjaftueshme për të lehtësuar punësimin dhe përparimin drejt arsimit e formimit profesional të mëtejshëm;
- mbështetje për t’u njohur me rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe për t’i zbatuar ato me rreptësi;
- mbështetje për t’u njohur me teknologjitë e proceset teknologjike bashkëkohore e të perspektivës, që lidhen me kualifikimin profesional përkatës;
- mbështetje për të zhvilluar ndjenjën e disiplinës, kuriozitetin intelektual dhe profesional, aftësitë sipërmarrëse, si dhe vlerat morale;
- mbështetje për t’u zhvilluar psikologjikisht dhe fizikisht, për të përballuar vështirësitë që do të ndeshin gjatë veprimtarive të ardhshme profesionale;
- mbështetje për të zhvilluar frymën e tolerancës dhe të mirëbesimit nëpërmjet përvojës së punës.

II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në profilin “Guidë turistike”, niveli III i KSHK.

1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në profilin “Guidë turistike”, niveli III i KSHK.

Në shkollat që ofrojnë arsimin profesional në profilin mësimor “Guidë turistike” niveli III i KSHK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë të rinjtë që:

- kanë mbaruar arsimin profesional në drejtimin mësimor “Hoteleri-turizëm”, niveli II i KSHK;
- janë të aftë fizikisht dhe mendërisht të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional.
- nëse kanë aftësi të kufizuara, shkolla krijon kushte dhe përshat programin në përputhje me paaftësitë që shfaqin.

Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitetet reale të këtyre shkollave, atëherë, MFE përgatit udhëzime të veçanta me kritere të posaçme pranimi për këto shkolla.

2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësve në përfundim arsimit në profilin “Guidë turistike”, niveli III i KSHK.

Në përfundim të arsimit profesional në profilin profesional “Guidë turistike”, niveli III i KSHK, nxënësi do të zotërojë këto kompetenca të përgjithshme kryesore:

- të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme.
- të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.
- të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më efçente.
- të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale.
- të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij.
- të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij.
- të organizojë drejt procesin e të nxënës të tij dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
- të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar.
- të vlerësojë dhe vetvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.

3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin mësimor “Guidë turistike”, niveli III i KSHK.

Në përfundim të arsimit profesional në profilin profesional “Guidë turistike”, niveli III i KSHK, nxënësi do të jetë i aftë të zhvillojë më tej kompetencat profesionale të fituara në nivelin II të KSHK, si dhe të ushtrojë kompetenca të tjera profesionale, si më poshtë:

- të listojë llojet kryesore të turizmit duke përshkruar karakteristikat e tyre;
- të zbatojë rregullat e komunikimit dhe etikës profesionale gjatë drejtimit të grupit turistik;
- të zbatojë kodin botëror të etikës në turizëm;
- të zbatojë teknikat e udhërrëfimit për grupin turistik gjatë tureve në këmbë;
- të zbatojë teknikat e udhërrëfimit për grupin turistik gjatë tureve me mjete transporti;
- të zbatojë teknikat e udhërrëfimit për grupin turistik në mjedise të mbyllura;
- të menaxhojë grupin sipas programit të përcaktuar;
- të menaxhojë marrëdhëniet me të tretët;
- të kujdeset për komoditetin dhe kënaqësinë e çdo pjesëmarrësi në udhëtim;
- të përcjellë dhe interpretojë informacionin, sipas programit;
- të administrojë dokumentacionin e programit turistik;
- të promovojë vlerat unike të sipërmarrjes dhe destinacionit turistik;
- të zbatojë kuadrin ligjor në fuqi;
- të zbatojë standardet e cilësisë së shërbimeve;
- të zbatojë rregullat e higjienës, të mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë udhërrëfimit të turistëve për realizimin e programit turistik;
- të interpretojë hartat turistike dhe hartat tematike speciale;
- të ruajë gjithmonë reputacionin dhe imazhin e tij profesional si udhërrëfyes i licencuar turistik;
- të përdorë terminologjinë e duhur në turizëm;
- të ofrojë asistencë, informacion dhe interpretime të trashëgimisë kulturore, historike e

- bashkëkohore për një grup të organizuar turistësh me vërtetësi dhe të përditësuar.
- të ketë respekt për natyrën dhe asetet kulturore;
- të çmojë identitetin dhe traditën e komuniteteve, duke shijuar të bukurën pa lënë asnjë ndotje pas (turizmi i qëndrueshëm).
- të përdorë teknologjinë e informimit dhe komunikimit gjatë shërbimeve të udhërrëfimit turistik.
- të zbatojë rregullat e sigurisë, higjienës dhe mbrojtjes së mjedisit.

4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtjshëm në përfundim të arsimit profesional në profilin mësimor “Guidë turistike”, niveli III i KSHK.

Përfundimi me sukses i arsimit profesional në profilin “Guidë turistike”, niveli III i KSHK, e pajis nxënësin me çertifikatën e punonjësit të kualifikuar në këtë profil profesional. Ky arsimim i jep mundësi nxënësit t’i drejtohet agjencive turistike dhe të udhëtimit, hoteleve dhe bizneseve të tjera në industrinë e mikpritjes, për t’u punësuar si udhërrëfyes turistik.

Me përfundimin e këtij niveli, nxënësi ka mundësi për vazhdimin e arsimimit në nivelin IV të KSHK (technik/manaxherial) të arsimit profesional (njëvjeçar) në drejtimin përkatës, për të fituar diplomën e “Maturës shtetërore profesionale”, me mundësi për vazhdimin e studimeve universitare dhe pas të mesmes.

III. Plani mësimor për arsimin profesional në profilin mësimor “Guidë turistike”, niveli III i KSHK.

Plani mësimor për profilin mësimor “Guidë turistike”, niveli III i KSHK (1 vjeçar)			
Nr	Kodi	Lëndët dhe modulet mësimore	Orët javore/ vjetore
			Klasa 12
A.		Lëndët e përgjithshme (Gjithsej)	8/9 (272/306)
1		Gjuhë shqipe	1
2		Letërsi	1
3		Gjuhë e huaj e parë	2
4		Gjuhë e huaj e dytë (me zgjedhje të lirë)	(1)
5		Matematikë	2
6		TIK	1
7		Edukim fizik, sporte, shëndet	1
B.		Lëndët profesionale (Gjithsej)	7 (238)
1	L-17-157-22	Bazat e sipërmarrjes	2
2	L-13-489-22	Guidë turistike	5
C.		Module të detyruar të praktikës profesionale (Gjithsej)	12 (408)
1	M-13-1836-22	Përdorimi i burimeve të informacionit për guida turistike	69
2	M-13-1494-19	Përgatitja për zbatimin e programit turistik	51
3	M-13-1498-22	Teknikat e komunikimit	51

4	M-13-988-19	Pritja dhe përcjellja e grupit turistik	68
5	M-13-1495-22	Guida gjatë tureve në këmbë	68
6	M-13-1496-22	Guida gjatë tureve me mjete transporti	68
7	M-13-1817-22	Komunikimi në gjuhën angleze në hoteleri-turizëm - 2	33
D.		Modulet e praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar (Gjithsej)	3 (102)
1	M-13-1499-19	Prezantimi i asetëve kombëtare dhe rajonale	51
2	M-13-1497-22	Guida gjatë tureve në mjedise të mbyllura	51
3	M-26-1580-19	Marketingu dixhital	51
		Gjithsej A+B+C+D	30/31 (1020/1054)

IV. Udhëzime për planin mësimor

Në klasën 12, viti shkollor ka gjithsej 36 javë (34 javë mësimore + 2 javë provime)

Një javë mësimore ka jo më shumë se 32 orë mësimore (teorike dhe praktike).

Një orë mësimore zgjat 45 minuta.

Kurrikuli i arsimit profesional në profilin “Guidë turistike”, niveli III i KSHK, përbëhet nga 4 grupe elementesh kurrikulare:

- Lëndët e kulturës së përgjithshme, të përbashkëta për drejtimet e ndryshme të këtij niveli (programet e detajuara të tyre jepen në një dokument të veçantë të MAS).
- Lëndët e kulturës profesionale (programet e përgjithëshme janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale të detyruara (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale me zgjedhje të detyruar (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).

Rekomandohet që modulet e praktikës profesionale të realizohen në ndarje ditore 3 orëshe ose 6 orësh.

V. Udhëzime për procesin mësimor.

Mësuesit e lëndëve teorike profesionale dhe instruktorët e moduleve të praktikave profesionale duhet të përzgjedhin dhe përdorin forma dhe metoda mësimdhënieje të tilla që të nxisin maksimalisht të nxënit aktiv të nxënësve dhe të çojnë në krijimin e ta, të kompetencave të punës, të plota dhe të qëndrueshme.

E rëndësishme është që **planifikimi i mësimdhënies** të bazohet në një proces analize fillestare, i cili të marrë parasysh faktorë të tillë të rëndësishëm si, niveli i hyrjes së nxënësve, përmbajtja e hollësishme e lëndëve profesionale dhe e moduleve të praktikave profesionale të parashikuara dhe shkalla e integritit të tyre, objektivat konkretë që do të arrihen, mundësitë reale që ka shkolla për realizimin e veprimtarive mësimore etj. Për këtë planifikim duhet një bashkëpunim i ngushtë i të gjithë personelit mësimdhënës dhe drejtues të shkollës.

Elementi kyç për arritjen e suksesit në një proces të nxëni, është **motivimi i nxënësve**. Njohja e vazhdueshme e nxënësve me shkallën e përmbushjes së objektivave nga ana e tyre përbën një mekanizëm të fuqishëm motivimi, i cili duhet të shihet me përparësi nga mësuesit.

Një element tjetër që ndihmon suksesin është **integrimi i teorisë me praktikën** e profesionit. Parimi i “të nxënit duke bërë” duhet të gjejë vendin e duhur në procesin e të mësuarit në shkollat profesionale të profilit mësimor “Guidë turistike”, niveli III i KSHK.

Mësuesit dhe instruktorët duhet të përdorin metoda të tilla të të mësuarit që zhvillojnë jo vetëm njohuritë teorike, shkathtësitë dhe shprehjet praktike të nxënësve, por edhe qëndrimet e tyre ndaj jetës, punës dhe shoqërisë në përgjithësi. *Puna në grup* dhe *Puna me projekte* janë dy nga format bazë të organizimit të mësimit (teorik ose praktik) për të zhvilluar *kompetencat kyçe*, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me veprimtarinë profesionale në veçanti dhe jetën e profesionistit të ardhshëm, në përgjithësi.

Një parim tjetër që duhet respektuar nga mësuesit dhe instruktorët është fakti që *të nxënët nuk ndodh vetëm në mjediset e shkollës, por edhe jashtë tyre*. Dhënia e detyrave dhe puna kërkimore e pavarur e nxënësve ka një ndikim të dukshëm në formimin e tyre si profesionistë të ardhshëm të profilit profesional “Guidë turistike”.

VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.

Vlerësimi vjetor i nxënësve në lëndët teorike profesionale dhe modulet e praktikave profesionale bëhet nga vetë mësuesit dhe instruktorët përkatës, me metoda dhe instrumente vlerësimi të përgatitura ose përzgjedhura nga vetë ata. Vlerësimi i nxënësve të bëhet me nota (4-10) si për lëndët teorike, ashtu edhe për modulet praktike, si gjatë vitit, ashtu edhe në provimet përfundimtare.

Në përfundim të klasës 12, nxënësi i arsimuar në profilin mësimor “Guidë turistike”, niveli III i KSHK, i nënshtrohet provimeve të mëposhtme:

- a) Provimi i teorisë profesionale të integruar;
- b) Provimi i praktikës profesionale të integruar;

Në këto provime ata vlerësohen për shkallën e përvetësimit të kompetencave profesionale (njohurive, shprehive, vlerave dhe qëndrimeve), të nevojshme për të punuar në veprimtari të ndryshme profesionale që operojnë në fushën e turizmit, dhe u jepet certifikata në të cilën evidentohen notat përfundimtare të lëndëve teorike profesionale, të moduleve të praktikës profesionale, të lëndëve të përgjithshme, si dhe rezultatet e dy provimeve përfundimtare të nivelit III të KSHK.

VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit profesional në profilin mësimor “Guidë turistike”, niveli III i KSHK.

Me përfundimin e suksesshëm të arsimit profesional në profilin mësimor “Guidë turistike”, niveli III i KSHK, shkolla profesionale e pajis nxënësin me Dëftesën e përfundimit të këtij niveli si dhe me Certifikatën e aftësimit profesional, të cilat njihen në territorin e Republikës së Shqipërisë. Sipas modelit të miratuar nga MFE, këto dëshmi përmbajnë:

- a) Të dhënat për nxënësin, shkollën, vitin e përfundimit, kualifikimin e fituar, etj.
- b) Të dhëna për rezultatet e arritura nga nxënësi:
 - rezultatet në lëndët e përgjithshme, lëndët profesionale dhe modulet profesionale;
 - rezultatet e dy provimeve përfundimtare të Nivelit III të KSHK.

VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.

1. Lënda “Bazat e sipërmarrjes” (L-17-157-22). Kl. 12 – 68 orë

- Synimet e lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl. 12.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.12, nxënësit duhet:

- të përshkruajnë kuptimin, rëndësinë dhe rolin e sipërmarrjes në kontekstin individual dhe shoqëror
- të përshkruajnë veçoritë e sjelljes sipërmarrëse të individëve
- të analizojnë aftësitë dhe mundësitë personale në kontekstin e nismave sipërmarrëse
- të bëjnë vlerësimin e kërkesave, dëshirave, mundësive dhe vështirësive të tyre për karrierën e ardhshme
- të zbatojnë procedurat për zgjidhjen e problemeve dhe marrjen e vendimeve të duhura në lidhje me to.
- të mbajnë qëndrim kritik dhe krijues ndaj zgjidhjeve të bëra, sukseseve dhe dështimeve të mundshme
- të përshkruajnë dhe zbatojnë parimet e etikës së komunikimit dhe negocimit në kontekste të ndryshme jetësore
- të përshkruajnë dhe zbatojnë parimet e punës individuale dhe të punës në grup
- të analizojnë veçoritë e gadishmërisë, iniciativës dhe motivimit në kontekste të ndryshme jetësore
- të tregojnë përgjegjësi individuale dhe shoqërore në kontekste të ndryshme jetësore
- të planifikojnë, sigurojnë dhe përdorin me efikasitet burimet e ndryshme si mjedisin, paratë, kohën etj.
- të përshkruajnë veçoritë dhe kërkesat për udhëheqjen e sipërmarrjeve të ndryshme
- të përshkruajnë veçoritë dhe impaktin e globalizimit, informacionit, mjedisit dixhital dhe mediave sociale në shoqërinë e sotme dhe të së ardhmes
- të përshkruajnë veçoritë e sipërmarrjes së biznesit dhe të sipërmarrjes sociale
- të përshkruajnë format e ndryshme të organizimit të sipërmarrjeve dhe karakteristikat e tyre
- të analizojnë faktorët që ndikojnë në veprimtarinë e sipërmarrjeve, të tillë si tregjet, klientela, konkurenca, kostot etj.
- të përshkruajnë mjedisin ligjor dhe fiskal të sipërmarrjeve
- të përshkruajnë marrëdhëniet e punës në një sipërmarrje.
- të përshkruajë hapat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve individuale dhe kolektive në mjedisin e punës.

- Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.12 – 68 orë

Tema 1	Kuptimi, rëndësia dhe roli i sipërmarrjes	3 orë
Tema 2	Aftësitë (sjellja) sipërmarrëse	3 orë
Tema 3	Vetvlerësimi i potencialit personal	3 orë
Tema 4	Vlerësimi i kërkesave, dëshirave, mundësive dhe vështirësive	3 orë
Tema 5	Zgjidhja e problemeve dhe vendimmarrja	4 orë

Tema 6	Qëndrimi kritik dhe krijues ndaj zgjidhjeve të bëra, sukseseve dhe dështimeve	3 orë
Tema 7	Etika e komunikimit dhe negocimit	3 orë
Tema 8	Puna individuale dhe puna në grup	4 orë
Tema 9	Gadishmëria, iniciativa dhe motivimi	3 orë
Tema 10	Përgjegjësia individuale dhe shoqërore	3 orë
Tema 11	Menaxhimi eficient i burimeve	3 orë
Tema 12	Aftësitë udhëheqëse në kontekstin e sipërmarrjes	3 orë
Tema 13	Globalizimi, informacioni, mjedisi dixhital dhe mediat sociale	4 orë
Tema 14	Sipërmarrja e biznesit dhe sipërmarrja sociale	3 orë
Tema 15	Format e organizimit të sipërmarrjeve	5 orë
Tema 16	Konteksti i sipërmarrjeve	6 orë
Tema 17	Mjedisi ligjor i sipërmarrjeve	4 orë
Tema 18	Marrëdhëniet e punës	4 orë
Tema 19	Zgjidhja e mosmarrëveshjeve në mjedisin e punës	4 orë

2. Lënda “Guidë turistike” (L-13-489-22). Kl. 12 – 170 orë

• Synimet e lëndës “Guidë turistike”, kl. 12.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Guidë turistike”, kl.12, nxënësit duhet:

- të shpjegojnë kuptimin, rëndësinë dhe misionin e udhërrëfyesit turistik;
- të përshkruajnë legjislacionin në fuqi në lidhje me turizmin dhe liçensimin e guidës turistike;
- të shpjegojnë profilin e turistit dhe veçoritë e tij;
- të shpjegojnë tipologjinë e turistit bazuar në karakteristikat gjeografike, demografike dhe psikografike dhe të personalitetit.
- të shpjegojnë ndjeshmërinë e turistëve sipas prejardhjes etnike dhe kulturore;
- të përshkruajnë në mënyrë të përgjithshme kulturat e popujve të ndryshëm;
- të përshkruajnë veçoritë psikologjike të turistit dhe grupit turistik;
- të përshkruajnë llojet, karakteristikat dhe veçoritë e grupeve turistikë;
- të përshkruajnë motivet kryesore që nxisin njerëzit të udhëtojnë;
- të përgatisin dhe prezantojnë informacion rreth trashëgimisë kulturore të prekshme dhe të paprekshme;
- të përgatisin dhe prezantojnë informacion rreth monumenteve të kulturës në Shqipëri;
- të përgatisin dhe prezantojnë informacion rreth siteve më të rëndësishme arkeologjike në vendin tonë;
- të përgatisin dhe prezantojnë informacion rreth parqeve arkeologjike e artefakteve arkeologjike;
- të shpjegojnë fazat e zhvillimit të arkeologjisë në vendin tonë;
- të përgatisin dhe prezantojnë informacion rreth aspekteve sociale, ekonomike dhe politike

- të Shqipërisë;
- të përgatisin e prezantojnë informacion për gjeografinë e rajoneve të Shqipërisë;
 - të përgatisin dhe prezantojnë informacion për periudhat e ndryshme kohore të historisë së Shqipërisë;
 - të vlerësojnë lidhjen e turizmit me burimet dhe bukuritë natyrore, trashëgiminë kulturore dhe historike të vendit dhe mikpritjen.
 - të përshkruajë ngjarjet kryesore fetare e rituale, origjinën e llojet e tyre, kostumet, muzikën popullore, veglat muzikore.
 - të përgatisin dhe prezantojnë informacion për kulturën, letërsinë, muzikën, zakonet dhe traditat shqiptare;
 - të shpjegojnë dhe të shpjegojë harta të ndryshme të shqipërisë sipas llojeve të tyre duke interpretuar elementët dhe shenjat e tyre.
 - interpretojnë hartat turistike dhe hartat tematike speciale;
 - të shpjegojnë etikën në sjellje, paraqitje dhe veshje të udhërrëfyesve turistikë;
 - të shpjegojnë rëndësinë e komunikimit në profesionin e Udhërrëfyesit turistik;
 - të shpjegojnë rëndësinë e gjuhës së trupit dhe teknikat e saj në komunikim;
 - të përshkruajnë llojet dhe veçoritë e komunikimit me turistët;
 - të përshkruajnë aftësitë e teknikat e prezantimit dhe interpretimit në të folurin në publik;
 - të shpjegojë parimet e etikës profesionale.
 - të përshkruajnë parimet e Kodit Global të Etikës në turizëm;
 - të shpjegojnë mënyrat dhe kanalet e marketingut në turizëm;
 - të shpjegojnë hapat e nevojshme gjatë parapërgatitjes për drejtimin e grupit;
 - të përshkruajnë llojet dhe elementët përbërës të programit turistik;
 - të evidentojnë burimet ku bazohet hartimi i një programi turistik;
 - të shpjegojnë mënyrat për përzgjedhjen e informacionit të nevojshëm;
 - të përshkruajnë mënyrat për përzgjedhjen e elementëve promovues të turit;
 - të përshkruajnë rolin e udhërrëfyesit në kujdesin ndaj turistit;
 - të shpjegojnë rolin e udhërrëfyesit për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë së turistit;
 - të shpjegojnë procedurat dhe teknikat gjatë realizimit të tureve të ndryshme;
 - të shpjegojnë procedurat dhe etapat për pritjen e grupit turistik;
 - të shpjegojnë procedurat për akomodimin e grupit turistik;
 - të shpjegojnë detyrat dhe përgjegjësitë e udhërrëfyesit në mbyllje të turit;
 - të shpjegojnë aspektet kryesore logjistike në pritje, gjatë dhe në mbyllje të turit;
 - të sigurojnë informacion në lidhje me sfidat logjistike që mund të ndodhin para dhe gjatë një turi.
 - të planifikojnë në detaje në menyrë që të përmbushin kërkesat e klientëve në kohën e duhur dhe me kosto efektive;
 - të shpjegojnë mënyrat e zgjidhjes në rastet e ankesave të turistëve;
 - të përshkruajnë hapat që mund të ndërmerren për menaxhimin e problemeve, urgjencave dhe ankesave gjate turit;
 - të shpjegojnë parimet kryesore të turizmit të qëndrueshëm;
 - të shpjegojë faktorët që ndikojnë në zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit.
 - të shpjegojnë parimet e mbrojtjes së mjedisit gjate udhërrëfimit turistik;
 - të përgatisin dhe prezantojnë informacion rreth llojeve kryesore të turizmit në Shqipëri;
 - të shpjegojnë terminologjinë e përdorur në Industrinë e Turizmit;
 - të përgatisin dhe prezantojnë informacion rreth turizmit bregdetar në Shqipëri;
 - të përgatisin dhe prezantojnë informacion rreth turizmit kulturor, në Shqipëri;
 - të përgatisin dhe prezantojnë informacion rreth turizmit natyror-rural dhe ekoturizmit në Shqipëri;

- të përgatisin dhe prezantojnë informacion rreth zonave të mbrojtura dhe monumenteve të natyrës në Shqipëri;
- të dallojnë llojet e ndërmarrjeve në industrinë turistike;
- të shpjegojnë veçoritë e ndërmarrjeve në industrinë turistike;
- të shpjegojnë mënyrat e përzgjedhjes së llojeve të akomodimit dhe atraksioneve;
- të përshkruajnë llojet, format dhe veçoritë e strukturave akomoduese;
- të përshkruajnë llojet, format dhe veçoritë e restoranteve, bareve, kafeterive, fast-foodeve, shërbimeve catering dhe menceve;
- të përshkruajnë veçoritë e strukturave akomoduese në tragete, cruiser, etj
- të përshkruajnë forma të tjera të ndërmarrjeve në industrinë turistike (ndërmarrje turistike pritëse, të specializuara në përgatitjen e kongreseve, me karakter shkencor, profesional, pelegrinazh, shkollor, sportiv, etj);
- të përshkruajnë llojet dhe veçoritë e ndërmarrjeve të udhëtimit si shoqëritë e transportit ajror, rrugor, detar dhe hekurudhor;
- të përgatisin dhe të prezantojnë informacion rreth sektorëve të industrisë së udhëtimit;
- të përshkruajnë llojet, format dhe veçoritë e operatorëve turistikë (tour-operatorëve);
- të përshkruajnë llojet, format dhe veçoritë e agjencive të udhëtimit dhe të turizmit,
- të përshkruajnë organizatat në industrinë e turizmit si brenda vendit dhe ato internacionale (IATA etj);
- të shpjegojnë mënyrën e bashkëveprimit të udhërrëfyesit turistik me operatorët turistikë dhe agjencinë turistike;
- të përshkruajnë rastet e bashkëpunimit të udhërrëfyesit turistik me njësitë akomoduese;
- të përshkruajnë rastet e bashkëpunimit të udhërrëfyesit turistik me njësitë gastronomike;
- të përshkruajnë rastet e bashkëpunimit të udhërrëfyesit turistik me qendra të tjera atraksionesh;
- të përshkruajnë dokumentet e përdorur nga ndërmarrjet në industrinë turistike si: voucher, kontratat etj;
- të përshkruajnë dokumentacionin kryesor që lidhet me realizimin e programit turistik.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Guidë turistike”, kl.12 - 170 orë**

Tema 1	Hyrje në profesionin e udhërrëfyesit turistik	10
Tema 2	Veçoritë e turistëve dhe grupit turistik	16
Tema 3	Trashëgimia kulturore dhe historike në vendin tonë;	10
Tema 4	Arkeologjia shqiptare dhe sitet kryesore arkeologjike në Shqipëri;	10
Tema 5	Aspektet gjeografike, social ekonomike dhe politike në vendin tone	10
Tema 6	Komunikimi, etika, teknikat e prezantimit dhe interpretimit.	16
Tema 7	Programi turistik, informacioni, burimet dhe elementët përbërës	10
Tema 8	Njohuri mbi teknikat e udhërrëfimit, kujdesi dhe siguria për turistin	10
Tema 9	Fazat e zbatimit të veprimtarisë së udhërrëfimit nga pritja deri tek përcjellja e grupit	6
Tema 10	Aspekte logjistike të drejtimit të grupit turistik	10
Tema 11	Zgjidhja e problemeve në situata të ndryshme, ankesave, urgjencave gjatë turit	10
Tema 12	Kontributi i udhërrëfyesit turistik në mbështetje të turizmit të qëndrueshëm.	10
Tema 13	Një vështrim i përgjithshëm i llojeve kryesore të turizmit në Shqipëri	10

Tema 14	Ndërmarrjet në industrinë e turizmit	8
Tema 15	Terminologjia në industrinë e turizmit	8
Tema 16	Operatorët në industrinë turistike	8
Tema 17	Bashkëveprimi i guidës turistike me operatorët në industrinë turistike	8

IX. Përshkruesit e moduleve të detyruar të praktikës profesionale

1. Moduli “Përdorimi i burimeve të informacionit për guida turistike”

Drejtimi: Hoteleri - Turizëm

Profili: Guidë turistike

Niveli: III i KSHK

Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe Kodi	PËRDORIMI I BURIMEVE TË INFORMACIONIT PËR GUIDA TURISTIKE	M-13-1836-22
Qëllimi i modulit	Një modul praktik, që i pajis kursantët me aftësi praktike për të përdorur si duhet hartat turistike dhe burimet e publikuara për informacione bazë dhe të detajuara drejtuar klientit.	
Kohëzgjatja e modulit	69 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësi duhet të ketë përfunduar drejtimin mësimor “Hoteleri - Turizëm”, niveli II i KSHK.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi përdor hartat turistike. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">- të lexojë saktë hartat e ndryshme turistike të Shqipërisë dhe vendeve të ndryshme të Europës e Botës;- të lokalizojë saktë pikat kufitare të hyrjes dhe daljes nga Shqipëria dhe territoreve jashtë saj;- të përdorë saktë hartat turistike të Shqipërisë dhe vendeve të ndryshme të Europës dhe botës;- të lokalizojë saktë në hartë pikat më të rëndësishme turistike në Shqipëri dhe territoreve jashtë saj;- të lokalizojë me saktësi zonat me vlera kulturore, historike, fetare dhe arkeologjike shqiptare;- të ndërtojë itinerare grafikë, bazuar në kërkesën e klientit;- të përshkruajë saktë rrugën drejt një destinacioni të kërkuar turistik;- të përdorë saktë shkallën e hartës për llogaritjen e largësive;- të specifikojë në hartë kilometrat e duhur nga nisja deri në destinacion;- të prezantojë saktë në hartë itineraret për ti ofruar te klienti. Instrumentet e vlerësimit: <ul style="list-style-type: none">- Pyetje përgjigje me gojë.- Vëzhgim me listë kontrolli.	

RM 2 Nxënësi përdor burime të publikuara, për të dhënë informacione bazë.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përcaktojë saktë kërkesën e marrë nga klientit;
- të përcaktojë saktë të dhënat e paketës turistike;
- të përdorë burime të publikuara (përfshirë dhe internetin), për informacion mbi oraret e mjeteve të ndryshme të transportit, cilësinë e shërbimit dhe tarifën e tyre;
- të përdorë burime të publikuara, për informacion mbi strukturat akomoduese, cilësinë e shërbimit dhe tarifën e tyre;
- të përdorë burime të publikuara, për informacion mbi strukturat gastronomike, cilësinë e shërbimit dhe tarifën e tyre;
- të përdorë edhe burime të tjera të mundshme, të besueshme mbi strukturat transportuese, akomoduese dhe gastronomike;
- të përdorë burime të publikuara, për informacion mbi kushtet e motit, turet, aktivitete artistike, festa, teatro, festivale, konferenca, mbi dyqanet dhe suvenirët, etj.;
- të përdorë burime të publikuara, për informacion të saktë në lidhje me rregullat doganore të destinacionit turistik;
- të përdorë të gjitha burimet e publikuara të mundshme, për informacionin bazë të paketës turistike ofruar klientit
- t'i ofrojë paraprakisht klientit informacionin bazë mbi destinacionin turistik, bazuar në kërkesat, interesat dhe motivet e udhëtimit të tij.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 3 Nxënësi përdor burime të publikuara, për të dhënë informacione shpesh.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përdorë burime të publikuara, për informacion të saktë mbi dokumentet e nevojshme për udhëtim në destinacionin përkatës;
- të përdorë burime të publikuara, për informacion të saktë mbi dokumentet e nevojshme të sigurimit shëndetësor;
- të përdorë burime të publikuara, për informacion të saktë mbi dokumentet e nevojshme për udhëtim, në raste të veçanta (kur udhëton me mjete individuale, kur udhëton në vendet që ka marrëveshje bilaterale, etj.);
- të përdorë burime të publikuara, për informacion të saktë mbi dokumentet e udhëtimit, për klientë të sëmurë, invalidë, fëmijë, fëmijë të pa shoqëruar, kafshë shoqëruese, etj.;
- të përdorë burime të publikuara, për informacion të saktë në

- lidhje me certifikatat e vaksinimit;
- të përdorë burime të publikuara, për informacion të saktë në lidhje me sigurinë personale (krimet, vendet e pasigurta, etj);
- të përdorë burime të publikuara, për informacion dhe udhëzime të sakta për besimtarët, personat VIP, tradita të veçanata të destinacioneve turistike, etj.;
- të përdorë burime të publikuara, për informacion të saktë mbi kursin ditor të këmbimit të monedhave.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve

- Ky modul duhet të trajtohet në kabinetin e guidës turistike të pajisur me internet dhe mjetet përkatëse për kryerjen e kësaj veprimtarie si dhe mjedise reale të punës në biznes.
- Rekomandohen dhe vizita në biznese që ofrojnë shërbim të guidës turistike.
- Mësuesi duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të teknikave të përdorimit të hartave turistike dhe burimeve të publikuara për informacione bazë dhe të detajuara drejtuar klientit.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune, fillimisht në mënyrë të mbikëqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur për të përdorur si duhet hartat turistike dhe burimet e publikuara për informacione bazë dhe të detajuara drejtuar klientit. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me veprimtaritë që kryejnë.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e detyrave të dhëna.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:
- Kabineti i guidës turistike në shkollës.
 - Kompjuter, fotokopje, shërbim interneti dhe programe kompjuterike për përdorimin e burimeve të informacionit për guida turistike
 - Manuale, udhëzues dhe materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
 - Bashkëpunim me agjenci udhëtimesh dhe turistike.
-

2. Moduli “Përgatitja për zbatimin e programit turistik”

Drejtimi: Hoteleri - Turizëm

Profili: Guidë turistike

Niveli: III të KSHK

Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe Kodi	PËRGATITJA PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT TURISTIK	M-13-1494-19
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësitë e nevojshme për të hartuar dhe prezantuar informacionin për vendin turistik sipas programit turistik.	
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësi duhet të ketë përfunduar drejtimin mësimor “Hoteleri - Turizëm”, niveli II i KSHK.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësi përgatit zbatimin e programit turistik. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të studiojë destinacionin turistik në paketën e përgatitur nga agjencia;- të përcaktojë pikënisjen në itinerarin turistik;- të hartojë sipas rregullit një përshkrim të shkurtër për destinacionin turistik;- të planifikojë afatet kohore në itinerarin turistik referuar kushteve mjedisore, klimaterike dhe mënyrës së udhëtimit;- të planifikojë afatet kohore në itinerarin turistik referuar profilit të grupit të turistëve;- të përshtasë afatet kohore në itinerarin turistik për çdo ndalesë;- të përshtasë afatet kohore në itinerarin turistik për pushim, ushqim dhe pazar;- të prezantojë itinerarin turistik.- të zbatojë rregullat e higjienës, të mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">- Pyetje përgjigje me gojë.- Vëzhgim me listë kontrolli. <p>RM 2 Nxënësi përgatit informacionin referuar itinerarit turistik. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p>	

- të studiojë itinerarin turistik të paketës turistike;
- të përcaktojë tematikat për informacion në udhëtimin turistik referuar tipologjisë së grupit;
- të analizojë dhe përshkruajë karakteristikat e përgjithshme gjeografike të destinacionit turistik;
- të analizojë dhe përshkruajë faktorët mjedisorë në informacionin turistik sipas destinacionit;
- të analizojë dhe përshkruajë faktorët socio-ekonomik në informacionin turistik sipas destinacionit;
- të analizojë dhe përshkruajë veçoritë historike, arkeologjike, kulturore në informacionin turistik;
- të analizojë dhe përshkruajë atraksione të tjera të destinacionit në informacionin turistik;
- të prezantojë informacionin turistik të hartuar.
- të zbatojë rregullat e higjienës, të mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 3 Nxënësi prezanton itinerarin turistik.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të prezantojë itinerarin e përgatitur;
- të shpërndajë itinerarin turistik partnerëve turistik;
- të bashkëpunojë profesionalisht me palët e treta;
- të përshkruajë itinerarin turistik para grupit turistik;
- të interpretojë profesionalisht itinerarin turistik sipas destinacionit në ecje, me mjete transporti, mjedise të mbyllura.
- të zbatojë rregullat e higjienës, të mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë prezantimit të itinerarit turistik.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

S

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve

- Ky modul duhet të trajtohet në kabinetin e guidës turistike të pajisur me internet dhe mjete përkatëse për kryerjen e kësaj veprimtarie si dhe mjedise reale të punës në biznes.
- Rekomandohen dhe vizita në biznese që ofrojnë shërbim të guidës turistike.
- Mësuesi duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të teknikave të komunikimit, prezantimit dhe përdorimit të mjeteve dhe teknikave përkatëse.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune, fillimisht në mënyrë të mbikëqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur për të hartuar dhe prezantuar informacionin për vendin turistik sipas programit turistik. Ata duhet të nxiten të

diskutojnë në lidhje me veprimtaritë që kryejnë.

- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e detyrave të dhëna.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:

- Kabineti i guidës turistike në shkollës.
 - Kompjuter, fotokopje, shërbim interneti dhe programe kompjuterike për të përgatitur dokumentet e nevojshme.
 - Manuale, udhëzues dhe materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
 - Bashkëpunim me agjenci turistike dhe udhëtuesh.
-

3. Moduli “Teknikat e komunikimit”

Drejtimi: Hoteleri - turizëm

Profili: Guidë turistike

Niveli: III i KSHK

Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe Kodi	TEKNIKAT E KOMUNIKIMIT	M-13-1498-19
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që aftëson nxënësit për zbatimin efikas të teknikave të komunikimit, si përdorimi i zërit me theks të veçantë, i gjuhës së trupit, si dhe i menaxhimit të emocioneve gjatë udhërrëfimit të grupit turistik.	
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësi duhet të ketë përfunduar drejtimin mësimor “Hoteleri - Turizëm”, niveli II i KSHK.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësi zbaton teknikat e komunikimit, me theks të veçantë përdorimin e zërit. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të dëgjohet nga turistët;- të përdorë fjalor të saktë;- të theksojë mirë fjalët;- të përdorë intonacionin e duhur;- të përdorë volumin e duhur të zërit;- të zbatojë rregullat e higjienës, të mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë komunikimit. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">- Pyetje përgjigje me gojë- Vëzhgim me listë kontrolli.	
	<p>RM 2 Nxënësi përdor teknikat e gjuhës së trupit gjatë prezantimit. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të përdorë duart sipas situatës;- të vendosë kontaktin sy me sy me grupin;- të pozicionohet saktë në lidhje me grupin dhe objektin që prezanton;- të përdorë, sipas tipologjisë së grupit, lëvizjet e kokës;- të zbatojë rregullat e higjienës, të mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përdorimit të gjuhës së trupit.	

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 3 Nxënësi menaxhon emocionet gjatë udhërrëfimit.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të provokojë kuriozitet te vizitorët;
- të tregojë fakte që evokojnë të kaluarën;
- të lidhë faktet me një temë specifike;
- të vendosë përherë një raport me vizitorët;
- të mos nëvleftësojë inteligjencën e vizitorëve;
- të mos mbivlerësojë inteligjencën personale.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve

- Ky modul duhet të trajtohet në mjedise reale pune gjatë udhërrëfimit të grupit, apo në mjedise të shkollës të përshtatura dhe të pajisura me mjetet përkatëse për kryerjen e kësaj veprimtarie. Rekomandohen dhe vizita në biznese që ofrojnë këtë shërbim.
- Mësuesi duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të teknikave të përdorimit të mjeteve dhe pajisjeve përkatëse.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune, fillimisht në mënyrë të mbikëqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me veprimtaritë që kryejnë. Rekomandohet të përdoret metoda e lojës me role.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e detyrave të dhëna.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:
- Mjedis i shkollës.
 - Kompjuter, dokumente, programe kompjuterike, etj.
 - Manuale, udhëzues dhe materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

4. Moduli “Pritja dhe përcjellja e grupit turistik”

Drejtimi: Hoteleri – Turizëm

Profili: Guidë turistike

Niveli: III i KSHK

Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe Kodi	PRITJA DHE PËRCJELLJA E GRUPIT TURISTIK	M-13-988-19
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që aftëson nxënësit për të zbatuar teknikat dhe procedurat e nevojshme në pritjen, rregjistrimin në strukturën akomoduese, transferimin dhe përcjelljen e një grupi turistik.	
Kohëzgjatja e modulit	68 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësi duhet të ketë përfunduar drejtimin mësimor “Hoteleri - Turizëm”, niveli II i KSHK.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi kryen procedurat e pritjes së grupit turistik. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">- të komunikojë paraprakisht me strukturat përkatëse pranë vendmbërritjeve;- të verifikojë sipas rregullit informacionin mbi mbërritjen e grupit; të marrë vendim për të kryer ndryshime në program në raste vonesash;- të konfirmojë sipas rregullit me transportuesin për kohën dhe vendin e saktë të pritjes në terminal (aeroport, port, tren, stacion autobusi) apo vende të tjera;- të përdorë teknikat identifikuese për të mundësuar turistët të dallojnë guidën e tyre turistike;- të përdorë mjediset e përshtatshme në terminal për të bashkuar grupin;- të verifikojë sipas rregullit listën e plotë të emrave për të regjistruar personat e mbërritur, mungesat dhe komentet;- të zbatojë procedurat për tu siguruar që të gjitha bagazhet janë transportuar deri tek mjete i transportit;- të kryejë sipas rregullit procedurat në rastet e humbjes së bagazheve;- të zbatojë rregullat e komunikimit në pritjen dhe përcjelljen me turistët për të inkurajuar ndjenja pozitive dhe vullnet të mirë;- të kryejë sipas rregullit dhënien e informacionit dhe këshillave gjatë transportimit nga terminali në hotel;	

-
- të zbatojë protokollin e veçantë në rast se shoqëron një ose më shumë persona me aftësi speciale.
 - të zbatojë rregullat e higjienës, të mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 2 Nxënësi rregjistron grupin turistik në strukturat akomoduese.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të informojë turistët mbi procedurat e akomodimit për të minimizuar konfuzionin dhe vonesat për t'u akomoduar;
- të komunikojë me hotelin për shkarkimin e bagazheve;
- të asistojë në procedurat për regjistrimin në hotel të turistëve;
- të koordinojë me recepsionin për regjistrimin e grupit sipas marrëveshjes me agjencinë apo kërkesave të çastit;
- të koordinojë me stafin e hotelin për lehtësimin e vështirësive të komunikimit gjuhësor;
- të koordinojë me hotelin për të lehtësuar transportimin e bagazheve në dhomat e klientëve;
- të informojë grupin në lidhje me vijimin e programit;
- të pajisë me program të gjithë grupin dhe të sigurohet që nuk ka asnjë paqartësi apo ndryshim;
- të zbatojë rregullat e higjienës, të mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 3 Nxënësi realizon transferimin dhe përcjelljen e grupit turistik.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të verifikojë sipas rregullit detajet e udhëtimit të kthimit të grupit, para fillimit të transferimit nga hoteli;
- të reflektojë ndryshimet në program sipas rregullit;
- të organizojë turistët për nisje nga hoteli, për të minimizuar humbjet e kohës në hollin e hotelit.;
- të përdorë listat e turistëve me të gjitha detajet për turistët që largohen;
- të këshillojë turistët për të verifikuar marrjen e të miturve, bagazheve, sendeve personale, biletave, pasaportave, etj. nga struktura akomoduese;
- të këshillojë për procedura të tjera në aeroport, kërkesat për blerjet pa taksa (duty free), etj.

- të marrë përshtypjet mbi produktet e shërbimet e ofruara;
- të delegojë saktë përshtypjet e klientëve tek Tour operatori agjencia;
- të praktikojë procedurat e rregullta të check- in dhe check – out në терминаlet e transportit;
- të zbatojë rregullat e higjienës, të mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë transferimit dhe përcjelljes së grupit turistik.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve

- Ky modul duhet të trajtohet në kabinetin e guidës turistike të pajisur me internet dhe mjetet përkatëse për kryerjen e kësaj veprimtarie si dhe mjedise reale të qyteteve, fshatrave apo në vende të hapura arkeologjike, historike.
- Rekomandohen dhe vizita në biznese që ofrojnë shërbim të guidës turistike.
- Mësuesi duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të teknikave të komunikimit, prezantimit dhe përdorimit të mjeteve dhe teknikave përkatëse. Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune, fillimisht në mënyrë të mbikëqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur për të zbatuar teknikat dhe procedurat e nevojshme në pritjen, regjistrimin në strukturën akomoduese, transferimin dhe përcjelljen e një grupi turistik. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me veprimtaritë që kryejnë. Rekomandohet të përdoret metoda e lojës me role.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e detyrave të dhëna.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Kabineti i guidës turistike në shkollës.
 - Kompjuter, fotokopje, shërbim interneti dhe programe kompjuterike për të përgatitur dokumentet e nevojshme.
 - Manuale, udhëzues dhe materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

5. Moduli “Guida gjatë tureve në këmbë”

Drejtimi: Hoteleri – turizëm

Profili: Guidë turistike

Niveli: III i KSHK

Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe Kodi	GUIDA GJATË TUREVE NË KËMBË	M-13-1495-22
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që aftëson nxënësit për të përgatitur informacionin përpara fillimit të udhëtimit, për të zbatuar teknikat e pozicionimit, të të folurit, dhënies së informacionit gjatë udhëheqjes së turistëve në lëvizje në këmbë nga një destinacion në tjetrin.	
Kohëzgjatja e modulit	68 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësi duhet të ketë përfunduar drejtimin mësimor “Hoteleri - Turizëm”, niveli II i KSHK.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësi përgatit informacionin përpara fillimit të udhëtimit. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të kontrollojë itinerarin e lëvizjes së turistëve;- të kryejë kërkimet e nevojshme: historike, të interesit të veçantë, anekdoda interesante;- të informohet me emrat e vendeve;- të informohet me terminologjinë vendase;- të informohet mbi traditat vendase;- të identifikojë pikat më të mira të vështrimit;- të identifikojë vendndodhjen e WC-ve, taksive dhe transportin publik më të afërt;- të zbatojë rregullat e higjienës, të mbrojtjes në punë dhe të mbrojtjes ruajtjes së mjedisit. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">- Pyetje përgjigje me gojë.- Vëzhgim me listë kontrolli. <p>RM 2 Nxënësi zbaton teknikat e dhënies së informacionit në vendin e vizitës. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të prezantojë një përmbledhje të historisë dhe zhvillimit të vendit të vizitës;- të prezantojë informacionin mbi arkitekturën e ndërtesave etj;	

- të krijojë lidhje gjatë shpjegimit me njerëz/ngjarje të njohura;
- të jetë i saktë, faktik dhe argëtues;
- të komentojë duke përmbledhur sipas teknikës së 5 W-ve:
 - të tregojë se (what) çfarë është dhe nga çfarë materiale përbëhet;
 - nga vjen (where)?
 - kur është bërë dhe si është bërë (when)?
 - kush e bëri dhe për kë e bëri (who) ?
 - pse ndodhet aty, kontekstin dhe kuptimin e saj (why)?
- të zbatojë rregullat e higjienës, të mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë dhënies së informacionit turistëve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 3 Nxënësi zbaton teknikat e pozicionimit dhe të të folurit.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të grumbullojë grupin përpara se të flasë;
- të përdorë teknikën e pozicionimit “këndi 45 gradë”;
- të qëndrojë në njërin anë të objektit;
- të vendosë vizitorët në një gjysëm rrethi në mënyrë që të shikojnë të gjithë;
- të flasë gjithnjë me fytyrë nga grupi;
- të komunikojë në tonalitetin e duhur, sa të degjohet nga grupi, por që të mos irritojë vizitorët;
- të përdorë kufjet/sistemin “Pëshpërimë”, nëse është i disponueshëm;
- të mos bllokohet rrugën e vizitorëve të tjerë.
- të zbatojë rregullat e higjienës, të mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje – përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve

- Ky modul duhet të trajtohet pjesërisht në kabinetin e guidës turistike të pajisur me internet dhe mjetet përkatëse për kryerjen e kësaj veprimtarie si dhe mjedise reale të qyteteve, fshatrave apo në vende të hapura arkeologjike, historike.
- Rekomandohen dhe vizita në biznese që ofrojnë shërbim të guidës turistike.
- Mësuesi duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të teknikave të komunikimit, prezantimit dhe përdorimit të mjeteve dhe teknikave përkatëse.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune, fillimisht në mënyrë të mbikëqyrur dhe më pas në mënyrë të

pavarur, për të përgatitur informacionin përpara fillimit të udhëtimit, për të zbatuar teknikat e pozicionimit, të të folurit, dhënies së informacionit gjatë udhëheqjes së turistë në lëvizje në këmbë nga një destinacion në tjetrin. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me veprimtaritë që kryejnë. Rekomandohet të përdoret metoda e lojës me role.

- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e detyrave të dhëna.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:

- Kabineti i guidës turistike në shkollës.
 - Kompjuter, fotokopje, shërbim interneti dhe programe kompjuterike për të përgatitur dokumentet e nevojshme.
 - Manuale, udhëzues dhe materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

6. Moduli “Guida gjatë tureve me mjete transporti”

Drejtimi: Hoteleri – Turizëm

Profili: Guidë turistike

Niveli: III i KSHK

Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe Kodi	GUIDA GJATË TUREVE ME MJETE TRANSPORTI	M-13-1496-22
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që aftëson nxënësit për të udhëhequr një grup turistësh, duke përdorur të gjithë logjistikën e mundshme dhe teknikat e udhërrëfimit me mjete të ndryshme transporti.	
Kohëzgjatja e modulit	68 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësi duhet të ketë përfunduar drejtimin mësimor “Hoteleri - Turizëm”, niveli II i KSHK.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësi përcakton hapat e veprimeve përpara udhëtimit. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të konfirmojë emrin e kompanisë së automjetit, targën/numrin e automjetit, permasat e tij, lartësinë dhe ngjyrën;- të konfirmojë emrin e shoferit dhe numrin e telefonit të automjetit;- të mësojë rrugën kryesore dhe rrugët alternative të udhëtimit;- të mësojë vendin e parkimit të automjetit;- të mësojë vendet e marrjes dhe zbritjes së pasagjerëve;- të mësojë vendet ku automjetet nuk mund të ndalojnë apo udhëtojnë.- të zbatojë rregullat e higjienës, të mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">- Pyetje përgjigje me gojë.- Vëzhgim me listë kontrolli.	
	<p>RM 2 Nxënësi përdor të gjithë logjistikën e mundshme përpara udhëtimit. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të gjejë automjetin;- të prezantohet me shoferin;- të gjejë mikrofonin/të testojë mikrofonin;	

- të gjejë kutinë e ndihmës së shpejtë, fikësen e zjarrit, daljet e emergjencës, etj;
- të diskutojë me shoferin: itinerarin, rrugët, etj;
- t'i japë mirëseardhjen grupit në momentin kur ata hyjnë në automjet;
- të numërojë pasagjerët;
- të prezantojë vehten dhe shoferin;
- të paraqesë programin/ itinerarin;
- të japë informacion se kur dhe ku do të mbarojë udhëtimi;
- të instruktojë grupin që nuk duhet ecur në koridorin e automjetit kur ai është në lëvizje.
- të zbatojë rregullat e higjienës, të mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përdorimit të logjistikës para udhëtimit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje pergjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 3 Nxënësi zbaton teknikat e udhërrëfimit në mjete transporti.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të pozicionohet në vendin e duhur;
- të MOS ngrihet në këmbë gjatë kohës që mjete është në lëvizje;
- të zbatojë legjislacionin e vendit përsa i përket qëndrimit/ ecjes në një mjet në lëvizje dhe përdorimit të rripave të sigurimit;
- të zotërojë teknikat e mikrofonit;
- të artikulojë qartë fjalët gjatë udhërrëfimit në mjetin e transportit;
- të përdorë komente përshkruese dhe specifike gjatë transportit në mjetin e transportit;
- të zbatojë rregullat e higjienës, të mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë udhërrëfimit me automjet.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje pergjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve

- Ky modul duhet të trajtohet në kabinetin e guidës turistike të pajisur me internet dhe mjetet përkatëse për kryerjen e kësaj veprimtarie si dhe praktikohet në automjete.
- Rekomandohen dhe vizita në biznese që ofrojnë shërbim të guidës turistike.
- Mësuesi duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të teknikave të komunikimit, prezantimit dhe përdorimit të mjeteve dhe teknikave përkatëse.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune,

fillimisht në mënyrë të mbikëqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur, për të udhëhequr një grup turistësh, duke përdorur të gjithë logjistikën e mundshme dhe teknikat e udhërrëfimit me mjete të ndryshme transporti. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me veprimtaritë që kryejnë. Rekomandohet të përdoret metoda e lojës me role.

- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e detyrave të dhëna.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:

- Kabineti i guidës turistike në shkollës.
 - Udhëtime të organizuara me automjete.
 - Kompjuter, fotokopje, shërbim interneti dhe programe kompjuterike për të përgatitur dokumentet e nevojshme.
 - Manuale, udhëzues dhe materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

7. Moduli “Komunikimi në gjuhën angleze në hoteleri turizëm -2

Drejtimi: Hoteleri - Turizëm
Profili: Guidë turistike
Niveli: III i KSHK
Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe Kodi	KOMUNIKIMI NË GJUHËN ANGLEZE NË HOTELERI TURIZËM - 2	M-13-1817-22
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson nxënësit për të komunikuar me etikë profesionale, në gjuhën angleze, gjatë kryerjes së veprimtarive profesionale që lidhen me guidën turistike.	
Kohëzgjatja e modulit	33 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësi duhet të ketë përfunduar Modulin “Komunikimi në gjuhën angleze në hoteleri turizëm – 1”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi komunikon në anglisht, ballë për ballë me klientin, gjatë veprimtarive profesionale. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">- të komunikojë gjatë mikpritjes së klientit- të komunikojë gjatë marrjes së informacioneve të nevojshme nga klienti.- të komunikojë me klientin për nevojat dhe kërkesat e veçanta.- të komunikojë me klientin gjatë marrjes së kërkesës për shërbime të ndryshme.- të informojë klientin në lidhje me shërbimet që ofrohen.- të informojë klientin në lidhje me aspektet financiare dhe pagesat për shërbimet që ofrohen.- të informojë klientin në lidhje me kujdesin dhe rreziqet e mundëshme.- të orientojë klientin për veprimtari të ndryshme që zhvillohen në rajon.- të informojë klientin në lidhje me objektet e trashëgimisë kulturore dhe historike në rajon.- të komunikojë me klientin gjatë shoqërimit të tij.- të komunikojë me klientin gjatë kryerjes së shërbimeve të ndryshme.- të komunikojë me klientin për pagesat e shërbimeve të marra.- të komunikojë me klientin për aspekte të ndryshme që lidhen me shërbimet e ofruara.	

-
- të komunikojë me klientin për marrjen e përshtypjeve të tyre në lidhje me shërbimet e marra.
 - të komunikojë me klientin gjatë përcjelljes së tij.
 - të komunikojë me klientin duke zbatuar rregullat e gjuhës së trupit.
 - të komunikojë me etikë profesionale me klientin.

Instrumentet e vlerësimit

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 2 Nxënësi komunikon me shkrim, në anglisht, gjatë veprimtarisë profesionale.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatitë dokumente pune.
- të plotësojë formate pune.
- të interpretojë dokumentacionin e shkruar.
- të interpretojë mesazhet e marra
- të kthejë përgjigje me shkrim.
- të komunikojë me shkrim me *e-mail*
- të komunikojë me shkrim nëpërmjet *Whatsapp*
- të komunikojë me shkrim nëpërmjet *Instagram*
- të komunikojë me shkrim nëpërmjet *Facebook*
- të komunikojë me shkrim me platforma dixhitale profesionale.
- të komunikojë me shkrim, duke zbatuar rregullat e komunikimit zyrtar.
- të komunikojë me shkrim, duke zbatuar rregullat e komunikimit gjysëm-zyrtar.
- të komunikojë me shkrim, duke zbatuar rregullat e komunikimit jozyrtar.
- të komunikojë me shkrim, duke zbatuar rregullat e drejtëshkrimit në gjuhën angleze.
- të komunikojë me shkrim, duke zbatuar rregullat e etikës profesionale.

Instrumentet e vlerësimit

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 3 Nxënësi komunikon me telefon, në anglisht, gjatë veprimtarisë profesionale.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të mirëpresë telefonatën e klientit.
- të marrë informacion nga klienti, në telefon.
- të komunikojë me klientin në telefon, për nevojat dhe kërkesat e veçanta të tij.
- të interpretojë informacionin e marrë me telefon, nga klienti.

- të komunikojë me klientin në telefon, gjatë marrjes së kërkeses për shërbime të ndryshme.
- të informojë klientin me telefon, në lidhje me shërbimet që ofrohen.
- të informojë klientin me telefon, në lidhje me aspektet financiare dhe pagesat për shërbimet që ofrohen.
- të negociojë me klientin me telefon, për shërbimet që ofrohen dhe çmimet e tyre.
- të informojë klientin me telefon, në lidhje me kujdesin dhe rreziqet e mundëshme.
- të orientojë klientin me telefon, për veprimtari të ndryshme që zhvillohen në rajon.
- të informojë klientin me telefon, në lidhje me objektet e trashëgimisë kulturore dhe historike në rajon.
- të komunikojë me klientin me telefon, për aspekte të ndryshme që lidhen me shërbimet e ofruara.
- të komunikojë me klientin me telefon, për marrjen e përshtypjeve të tyre në lidhje me shërbimet e ofruara.
- të komunikojë me telefon, me klientin, me etikë profesionale.

Instrumentet e vlerësimit

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet në klasa mësimore si dhe në mjediset e praktikave profesionale të shkollës, të pajisjura me mjetet e duhura.
- Ky modul mund të trajtohet edhe në mjedise reale të punës në bizneset e sektorit të hoteleri turizmit, me klientë realë.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete për të komunikuar në gjuhën angleze gjatë kryerjes së shërbimeve të ndryshme në sektorin e hoteleri turizmit.
- Mësuesi i modulit duhet të demonstrojë shembuj të komunikimit në gjuhën angleze gjatë veprimtarive praktike në sektorin e hoteleri turizmit, sikurse parashikohen në modul.
- Rekomandohet të përdoren sa më shumë metodat e lojës me role dhe të simulimit, në lidhje me aspektet e komunikimit në gjuhën angleze, në veprimtaritë e sektorit të hoteleri turizmit.
- Mësuesi i modulit duhet të moderojë seanca të diskutimeve në grup, në lidhje me veprimtaritë e komunikimit në gjuhën angleze, të kryera më parë.
- Mësuesi i modulit duhet të theksojë faktin që, jo vetëm përdorimi i gjuhës angleze, korrekte dhe me terminologjinë e duhur, por edhe etika e komunikimit është pjesë e rëndësishme e veprimtarisë së suksesshme në fushën e hoteleri turizmit.
- Mësuesi i modulit duhet të japë detyra shtëpie për nxënësit, që ata të studiojnë aspekte të komunikimit dhe të fjalorit në gjuhën angleze, që përdoren në veprimtari të ndryshme

profesionale, në sektorin e hoteleri turizmit.

- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet t'i vihet theksi verifikimit të shkallës së arritjeve në lidhje me komunikimin korrekt dhe me etikën e duhur në gjuhën angleze, në veprimtaritë profesionale të sektorit të hoteleri turizmit.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, mjetet, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Mjedise të ndryshme, reale ose të simuluar, që kanë të bëjnë me veprimtaritë profesionale në sektorin e hoteleri turizmit.
 - Orenditë, mjetet, pajisjet dhe materialet e nevojshme për shërbimet në sektorin e hoteleri turizmit.
 - Pajisje elektronike me programet e nevojshme të komunikimit.
 - Kompleti i ndihmës së shpejtë.
 - Fjalorë frazeologjikë të gjuhës angleze.
 - Adresa interneti që trajtojnë aspekte të komunikimit në gjuhën angleze në sektorin e hoteleri turizmit.
 - Manuale, udhëzuesa, formate dokumentash, materiale informuese, materiale të shkruara në gjuhën angleze, në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

X. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar

1. Moduli “Prezantimi i aseteve kombëtare dhe rajonale”

Drejtimi: Hoteleri - turizëm

Profili: Guidë turistike

Niveli: III i KSHK

Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe Kodi	PREZANTIMI I ASETEVE KOMBËTARE DHE RAJONALE	M-13-1499-19
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që aftëson nxënësit për të prezantuar asetet në territorin e Shqipërisë dhe rajonet e saj, duke përdorur pika reference gjatë udhërrëfimit.	
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësi duhet të ketë përfunduar drejtimin mësimor “Hoteleri - Turizëm”, niveli II i KSHK.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësi prezanton territorin e Shqipërisë. <i>Kriteret e vlerësimit:</i> Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të përshkruajë artin, arkitekturën, letërsinë, muzikën, pikturën dhe skulpturën kombëtare;- të prezantojë sistemin e edukimit të vendit;- të prezantojë çështjet kryesore të mbrojtjes së mjedisit;- të përshkruajë sistemin gjeologjik të vendit;- të prezantojë etapat kryesore të historisë së vendit;- të prezantojë sistemin politik të vendit;- të prezantojë përbërjen fetare të popullsisë;- të dallojë destinacionet kryesore turistike të vendit;- të zbatojë aftësitë dixhitale për prezantimin e teritorrit të Shqipërisë. <p><i>Instrumentet e vlerësimit:</i></p> <ul style="list-style-type: none">- Pyetje përgjigje me gojë.- Vëzhgim me listë kontrolli.	
	<p>RM 2 Nxënësi prezanton rajonin ku jeton. <i>Kriteret e vlerësimit:</i> Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të prezantojë arkitekturën e rajonit;	

- të prezantojë traditat e rajonit;
- të përshkruajë florën dhe faunën e rajonit;
- të përshkruajë kulturën e monumentet e rajonit;
- të përshkruajë çështjet socio-ekonomike të rajonit;
- të prezantojë sportet që luhen në rajon;
- të tregojë shtigjet kryesore natyrore të rajonit;
- të zbatojë aftësitë dixhitale për prezantimin e rajonit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 3 Nxënësi përdor pika reference gjatë udhërrëfimit.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë vizitorët;
- të menaxhojë mirë kohën;
- të mundësojë lidhje të fakteve në hapësirë dhe në kohë;
- të jetë KISS (keep it short and simple);
- të përdorë termat teknike dhe datat e duhura;
- t'i përgjigjet, përmes perifrimit, pyetjeve të vizitorëve;
- të zbatojë aftësitë dixhitale për prezantimin e pikave të referencës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Pyetje përgjigje me gojë

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve

- Ky modul duhet të trajtohet në mjedise reale pune apo në mjedise të shkollës të përshtatura dhe të pajisura me mjetet përkatëse për kryerjen e kësaj veprimtarie. Rekomandohen dhe vizita në biznese që ofrojnë këtë shërbim.
- Mësuesi duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të teknikave të përdorimit të mjeteve dhe pajisjeve përkatëse.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune, fillimisht në mënyrë të mbikëqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur për të prezantuar asetet në territorin e Shqipërisë dhe rajonet e saj, duke përdorur pika reference gjatë udhërrëfimit. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me veprimtaritë që kryejnë. Rekomandohet të përdoret metoda e lojës me role.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e detyrave të dhëna.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

**Kushtet e
e domosdoshme
për realizimin e
modulit**

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:

- Mjedis real pune ose mjedis i shkollës.
 - Kompjuter, programe kompjuterike, dokumente.
 - Manuale, udhëzues dhe materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

2. Moduli “Guida gjatë tureve në mjedise të mbyllura”

Drejtimi: Hoteleri – Turizëm

Profili: Guidë turistike

Niveli: III KSHK

Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe Kodi	GUIDA GJATË TUREVE NË MJEDISE TË MBYLLURA	M-13-1497-22
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që aftëson nxënësit për të udhëhequr grupin turistik në muze, galeri arti etj., duke i promovuar këto mjedise të mbyllura.	
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësi duhet të ketë përfunduar drejtimin mësimor “Hoteleri - Turizëm”, niveli II i KSHK.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi zbaton listën e kontrollit përpara vizitës. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">- të informojë institucionin që është propozuar për vizitë ose konfirmojë vizitën e planifikuar;- të kontrollojë hyrjen për personat me aftësi ndryshe dhe të kërkojë ndihmë nëse nevojitet;- të kontrollojë praktikën për fotografim (leje, përdorim blic dhe video), shkopa mbajtës, çadra, çanta të mëdha e çanta kurrizi;- të informojë për mënyrat e futjes dhe veshjet në objektet të ndryshme të kultit- të kontrollojë oraret e hapjes së destinacioneve, shërbimit të ushqimit, dhe çdo objekti kulti që do të vizitohet etj;- të marrë informacion për shitjen e biletave elektronike në vendet e trashëgimisë kulturore e historike- të presë bileta elektronike në site të ndryshme elektronike- të informojë turistët për çmimet e tyre;- të kontrollojë orarin e mbylljes ;- të kontrollojë vendndodhjen e WC-ve/tualeteve.- të zbatojë rregullat e higjienës, të mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit. Instrumentet e vlerësimit: <ul style="list-style-type: none">- Vëzhgim me listë kontrolli.	

RM 2 Nxënësi udhëheq grupin në mjedise të mbyllura.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të mbërrijë herët, nëse vendtakimi me turistët është destinacioni që do vizitohet;
- të identifikojë vehten te stafi;
- të përshëndesë vizitorët dhe të prezantohet;
- të japë një përmbledhje të vizitës;
- të japë instruksione mbi kohën dhe vendin e largimit.
- të tregojë vendndodhjen e ËC-ve/ tualeteve/ banjove dhe dyqaneve.
- të udhëzojë grupin përr zbatimin e rregullores ne vendet e mbyllura.
- të zbatojë rregullat e higjienës, të mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë udhërrëfimit të grupit në vende të mbyllura.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 3 Nxënësi promovon mjedisin e mbyllur.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të flasë me pasion për destinacionin;
- të shpjegojë përdorimin aktual të mjedisit te mbyllur;
- të promovojë miqtë, donatorët dhe sponsorët e mjedisit te mbyllur;
- të udhëzojë për rregullat e veçanta të vizitës në një mjedis me karakter fetar;
- të udhëzojë grupin për veshjet e duhura gjatë vizitës në mjedisin e mbyllur.
- të zbatojë rregullat e higjienës, të mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë promovimit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve

- Ky modul duhet të trajtohet në kabinetin e guidës turistike të pajisur me internet dhe mjetet përkatëse për kryerjen e kësaj veprimtarie si dhe në muze/galeri etj.
- Rekomandohen dhe vizita në biznese që ofrojnë shërbim të guidës turistike.
- Mësuesi duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të teknikave të komunikimit, prezantimit dhe përdorimit të mjeteve dhe teknikave përkatëse.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune, fillimisht në mënyrë të mbikëqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur, për të udhëhequr grupin turistik në muze, galeri arti, etj, duke i promovuar këto vende. Ata duhet të nxiten të

diskutojnë në lidhje me veprimtaritë që kryejnë. Rekomandohet të përdoret metoda e lojës me role.

- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e detyrave të dhëna.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:

- Kabineti i guidës turistike në shkollës.
 - Akses në muze/galeri etj.
 - Kompjuter, fotokopje, shërbim interneti dhe programe kompjuterike për të përgatitur dokumentet e nevojshme.
 - Manuale, udhëzues dhe materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

3. Moduli “Marketingu dixhital”

Drejtimi: Hoteleri – Turizëm

Profili: Guidë turistike

Niveli: III KSHK

Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe Kodi	MARKETINGU DIXHITAL	M-26-1580-19
Qëllimi i modulit	Një modul që pajis nxënësit me njohuritë dhe aftësitë bazë për të mundësuar marketingun e biznesit përmes teknikave të ndryshme dixhitale	
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësi duhet të ketë përfunduar drejtimin mësimor “Hoteleri - Turizëm”, niveli II i KSHK.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësi përzgjedh platformën dixhitale dhe mediat sociale për promovimin dixhital. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë të:</p> <ul style="list-style-type: none">- të analizojë produktin të cilit do ti bëhet marketingu;- të analizojë veçoritë e kategorive të klientëve të mundshëm të produktit;- të identifikojë lloje të ndryshme të platformave dixhitale dhe mediave sociale;- të analizojë kriteret për përzgjedhjen e platformës dixhitale dhe medias sociale;- të përzgjedhë platformën dixhitale dhe median sociale;- të prezantojë platformën dixhitale dhe median sociale të përzgjedhur. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">- Vëzhgim me listë kontrolli.	
	<p>RM 2 Nxënësi përgatit materialet për hedhjen e tyre në platformën dixhitale dhe median sociale. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të përgatitë materiale të ndryshme interaktive (tekst, imazh, video etj.);- të ndërtojë video, duke përdorur programe (softëare) të ndryshme (psh. <i>Movie maker</i>, ose nëpërmjet aparatit celular, <i>smartphone</i> etj.);- të modifikojë imazhe të ndryshme me <i>softëare: photoshop, canva</i> etj.;	

- të ngarkojë (publikojë) materialet e mësipërme në platformën dixhitale dhe median sociale të përzgjedhur.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 3 Nxënësi menaxhon platformën dixhitale e mediat sociale.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të evidentojë gabimet e mundshme në materialet e ndryshme interaktive të hedhura në platformën dixhitale dhe median sociale;
- të modifikojë materialet e ndryshme interaktive (tekst, imazh, video etj.) në rast gabimesh;
- të fshijë materiale interaktive të panevojshme në platformën dixhitale dhe mediat sociale;
- të realizojë komunikimin dixhital me ndjekësit/klientët, përmes internetit/mesazheve në inbox ose komenteve të ndryshme për materialet e publikuara në platformën dixhitale;
- të monitorojë impaktin e mesazhit të kompanisë të ndjekësit/klientët;
- të nxitë ndjekësit/klientët që të veprojnë në përgjigje të mesazhit të kompanisë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 4 Nxënësi përgatit raporte të dhënash mbi përdorimin e platformës dixhitale dhe mediave sociale nga ndjekësit/klientët.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të evidentojë numrin e vizitorëve të platformës dixhitale dhe mediave sociale;
- të ndërtojë një paraqitje grafike mbi numrin e vizitorëve që aksesojnë platformën dixhitale dhe mediat sociale (ditore, javore, mujore);
- të evidentojë disa prej elementeve psikologjikë të *Marketingut Super Efektiv* nëpërmjet internetit/rjeteve sociale (të cilët bëjnë diferencën midis një fushate të pasuksesshme dhe një fushate jashtëzakonisht të suksesshme);
- të analizojë rolin e menaxherit të platformës dixhitale dhe mediave sociale duke u bazuar tek numri i personave që i aksesojnë ato.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 5 Nxënësi krijon një plan marketingu dixhital.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë një plan orar, ditor dhe javor në lidhje me publikimin/shpërndarjen e informacioneve të ndryshme në platformat e përzgjedhura;
- të krijojë fushata marketingu dixhital, duke përdorur burime të ndryshme reklamimi (rrjetet sociale, e-mail ose *mobile marketing*);
- të identifikojë fushata fituese, si dhe të mirëmbajë fushatat ekzistuese të marketingut për sukses maksimal;
- të sugjerojë, nëse është e mundur, zgjidhje të mirëfillta, të shumëllojshme dhe të mirëanalizuara për arritjen e perceptimit të mesazhit deri tek audienca e synuar dhe konsumatori final.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset e firmës ushtrimore, laboratorë të TIK ose në biznese.
- Ky modul kërkon, që rezultatet mësimore të realizohen on-lin
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shembujt konkretë dhe të nxisë kreativitetin.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune, duke rritur angazhimin e vizitorëve ne faqe, duke përgatitur shkrime interaktive, të krijojnë video promovuese, të masin efikasitetin e marketingut dixhital etj.
- Ata duhet të nxiten të diskutojnë dhe bashkëpunojnë në lidhje me proceset e punës për krijimin e një plani marketingu online
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës për krijimin dhe menaxhimin e marketingut dixhital.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Mjedise pune me kompjutera dhe lidhje interneti
 - Programe të ndryshme kompjuterike për realizimin e marketingut dixhital
 - Materiale kancelarie.
 - Pajisje për përgatitjen e materialeve promovuese
 - Informacione mbi marketingun dixhital.
 - Legjislacioni mbi marketingun dixhital.
 - Materiale udhëzuese
-